

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Enea Cenko (Avokat)

Në përgjigje të kërkesës suaj me nr. 7355 prot., datë 11.09.2023 drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në të cilën kërkon informacion mbi masën aktuale të përfitimit të znj. Naile Hasani, e përfaqësuar me prokurë nga ana juaj, ju sqarojmë si më poshtë:

Pasi shqyrtuam dosjen e përfitimit me nr. 224089/1, që i përket znj. Hasani, konstatojmë se i përket datëlindjes 03.04.1953 dhe moshën për pension pleqërie e ka plotësuar në datën 03.04.2013, sipas nenit 92, të ligjit 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Kërkesën për përfitim pensioni pleqërie e ka bërë në datën 05.09.2014.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, bazuar në nenin 31, 92, 96 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i ka caktuar znj. Hasani pension pleqërie të pjesëm rural, me vendim caktimi pensioni nr. 6487, datë 09.09.2014, në shumën 3.994 lekë në muaj, me periudhë sigurimi 15 vite, në shumën 3.994 lekë në muaj, me të drejtë pagese nga data 29.08.2014, datë në të cilën është bërë edhe pagesa e fundit si e vetëpunësuar në bujqësi, e cila e ka futur në kushte përfitimi për pension pleqërie me 15 vite periudhë sigurimi.

E drejta për përfitimi një personi të siguruar i lind kur plotëson kushtin e moshës dhe periudhën minimale të sigurimit të kërkuar në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar.

Periudha e përgjithshme e sigurimit, mbi bazën e të cilës i është llogaritur pensioni znj. Hasani, është si më poshtë:

- 01.09.1989 – 01.11.1993 Uzina e Kromit Kalimash;
- 01.11.1993 – 31.10.1994 asistencë;
- 01.11.1994 – 02.11.1998 e vetëpunësuar në bujqësi;
- 01.03.2011 – 31.05.2012 e vetëpunësuar në bujqësi;

- 01.06.2012 – 01.03.2013 e vetëpunësuar në bujqësi;
- vite 10 muaj e 4 ditë kooperativë bujqësore.

Masa e pensionit ka përfituar rritjet në zbatim të VKM-ve për rritjen e pensioneve dhe së bashku me kompensimet, duke filluar nga data nga 01.10.2022 të ardhurat mujore në pension të znj.Hasani janë në masën 5.681 lekë në muaj.

Faleminderit për mirëkuptimin.